



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

DETARI

Niveli IV në KSHK¹

J-IV-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	DETARI			Kodi J-IV-23
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në “Detari” niveli IV në KSHK, është të është të pajisë individin me njohuritë dhe shprehitë e nevojshme për ushtrimin e kompetencave profesionale në fushën e detarisë. Këto kompetenca do t’i shërbejnë për t’i dhënë mundësinë jo vetëm për punësim por edhe në një integrim më të shpejtë me praktikatat e aplikuara në këtë sektor.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet arsimore që ofrojnë kualifikimin profesional “Detari”, niveli IV në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të individët që: <ul style="list-style-type: none"> • kanë mbaruar kualifikimin profesional në një nga profilet e niveli III në KSHK, • kanë përvoja në det dhe në anijen në port jo më pak se 6 (gjashtë) muaj; • janë në kushte shëndetësore që lejojnë ushtrimin e këtij profesioni (kërkesat për shikimin dhe dëgjimin). 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Detari”, niveli IV në KSHK, e pajis individin Certifikatën Profesionale të nivelit dhe Supplementin përkatës, të teknik/menaxherit në këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në një: <ol style="list-style-type: none"> a. mjet lundrimi për qëllime tregtare; b. mjet lundrimi mbi 24 m gjatësi për qëllime peshkimi; c. mjet lundrimi të shërbimit portual; d. mjet lundrimi bregdetar të agjencive të zbatimit të ligjit në det; e. mjet lundrimi për qëllime kënaqësie të lundrimit bregdetar; f. mjet lundrimi bregdetar për qëllime kërkimore-shkencore; g. shoqëri menaxhimi mjeteve lundruese për qëllime tregtare ose peshkim; Me përfundimin e arsimit në Kualifikimin profesional “Detari”, niveli i IV në KSHK, ai/ajo fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare, si dhe mbas një përvoje pune në det me anijet dhe në sektorin përkatës, jo më pak se dymbëdhjetë (12) muaj, individi fiton të drejtën për t’u pajisur nga Administrata Detare Certifikatën e kualifikimit si zv. Kapiten anije Peshkimi Rreg. II/4 dhe/ose mekanik Shërbimi në anije peshkimi Rr. II/5 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW-’95 ¹ dhe/ose Marinar Kuverte Rreg. II/5 dhe/ose Motorist Rreg. III/5 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW’78 ² e ndryshuar.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	J-IV-17			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Planifikimi dhe organizimi i punës para daljes së mjetit në det:

- Të argumentojë rëndësinë e përditësimit me çmimet e produkteve të pritshme nga gjuetia;
- Të argumentojë rëndësinë e përditësimit me çmimet e hidrokarbureve (naftë, vaj lubrifikant, hidraulik, etj.) në treg;
- Të argumentojë rëndësinë e përditësimit me çmimet e furnizimeve ushqimore (ushqim, ujë i pijshëm, etj.) në treg;
- Të argumentojë rëndësinë e përditësimit me çmimet e ambalazhit dhe akullit, plastmasi mbrojtës, etj. në treg;
- Të vlerësojë mjetet dhe pajisjet e punës për daljen në det, përdorimin dhe funksionimin;
- Të vlerësojë nivelet e kualifikimit të kërkuar për mjetin e lundrimit në raport me dokumentacionin e kualifikimit të ekuipazhit;
- Të interpretojë parimet e menaxhimit të burimeve njerëzore në kushtet e një mjeti lundrues;
- Të përshkruajë hapësirën detare, ndarjen territoriale dhe instrumentat e monitorimit të saj;
- Të shpjegojë strategjinë sektoriale të peshkimit;
- Të interpretojë kushtet e zonave dhe periudhat e lejuara për gjueti;
- Të përshkruajë rreziqet e mundshme në tabanin e fundit të detit;
- Të listojë llojet, burimet, përmbajtjen dhe rëndësinë e njoftimeve meteorologjike, të trafikut, të aktiviteteve të tjera ushtarake, kërkimeve shkencore, gjeologjike, etj. për zonën;
- Të listojë detyrat e ekuipazhit para nisjes për lundrim;
- Të analizojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
- Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e punës për matjen e tankeve me hidrokarbure;
- Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e punës për matjen e tankeve me ujë të pijshëm;
- Të përshkruajë kategoritë e ushqimeve dhe rëndësinë e rezervës koloniale;
- Të shpjegojë mënyrat e sigurimit të rezervave hidrokarbure, ushqimore, mjeteve, pajisjeve të punës, burimeve njerëzore dhe materialeve të nevojshme;
- Të përshkruajë funksionet e Regjistri Detar dhe dokumentacioni që lëshon;
- Të përshkruajë funksionet e Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve dhe dokumentacionin që lëshon;
- Të përshkruajë funksionet e Inspektoriatit të peshkimit;
- Të përshkruajë funksionet e QNOD²;
- Të listojë llojet e licencave për aktivitetin ekonomik;
- Të interpretojë rastet dhe mënyrat e parandalimit të aksidenteve dhe incidenteve detare;
- Të interpretojë rëndësinë e siguracionit detar;
- Të interpretojë Planin Kombëtar të Reagimit ndaj Ndotjeve Detare në lidhje me peshkimin;
- Të shpjegojë fokusin kryesor të punës së organizatave me ndikim në det si: OKB³ IMO⁴,

² Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare

ILO⁵, FAO⁶, WHO⁷;

- Të shpjegojë fokusin kryesor të konventave dhe marrëveshjeve detare.

Sigurimi i gatishmërisë së mjetit për lundrim:

- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gatishmërisë së mjeteve dhe pajisjeve të punës para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të ngarkesës apo objekteve të lëvizshme para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të pajisjeve radionavigacionale para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të sistemit sinjalizues lundrimor para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të sistemit të drejtimit para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të motorit kryesor dhe agregateve ndihmues para daljes në det;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të panelit elektrik kryesor para daljes në det;
- Të interpretojë normat e lejuara të funksionimit të kapaciteteve mbledhëse të mbetjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të kapaciteteve të disponueshme mbledhëse të mbetjeve hidrokarbure para daljes në det
- Të interpretojë metodat e miratuara të shkarkimit të ndotësve detar;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të veshjes së sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të argumentojë rëndësinë e sigurimit të kushteve optimale të jetesës së ekuipazhit;
- Të argumentojë rëndësinë e gatishmërisë për përdorim të mjeteve të shpëtimit të jetës;
- Të argumentojë rëndësinë e gatishmërisë për përdorim të sistemit të mbrojtjes dhe reagimit në raste zjarri;
- Të interpretojë rëndësinë dhe format e raportimit;
- Të interpretojë rëndësinë dhe vlefshmërinë e certifikatave të kolaudimit periodik të mjeteve të shpëtimit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Mbikëqyra e veprimtarive në funksion të lundrimit:

- Të interpretojë hartat, projeksionet dhe shtrimin grafik të lundrimit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e regjistrimit të të dhënave lundrimore dhe të ecurisë së gjuetisë në ditarin e lundrimit/makinerisë;
- Të shpjegojë veglat e navigatorit dhe përdorimin e tyre për punën me hartën;
- Të shpjegojë teknikat, mënyrat dhe mjetet e testimit të gatishmërisë së sistemit të spirancave;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të AIS;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të Blue box;
- Të argumentojë rëndësinë e respektimit të grafikut të shërbim-pushimit të ekuipazhit;

³ Organizata e Kombeve të Bashkuara

⁴ Organizata Ndërkombëtare Detare

⁵ Organizata Ndërkombëtare e Punës

⁶ Organizata e Bujqësisë dhe e Ushqimit

⁷ Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit

- Të argumentojë rëndësinë e teknikave të menaxhimit të grupit të punës (ekuipazhit);
- Të argumentojë rëndësinë e teknikave të hedhjes/marrjes së veglës së gjuetisë në det;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të shenjave dhe simboleve të REPAD-it;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të shenjave dhe simboleve të Kodit Ndërkombëtar i sinjaleve të IMO-s⁸;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të shenjave dhe simboleve të Rregullave e IALA-s⁹;
- Të argumentojë rëndësinë e teknikave të kërkimit të tufave të peshkut;
- Të shpjegojë stabilitetin e mjetit lundrues dhe kontrollin në raste dëmtimesh strukturore në lundrim;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit me korrektësi të mënyrave dhe procedurave për përpunimin paraprak të produkteve nga gjuetia;
- Të interpretojë parimet dhe metodat e kërkim shpëtimit në det;
- Të interpretojë parimet dhe metodat e manovrimit të mjetit lundrues në det për shmangien e përplasjeve;
- Të interpretojë teknikat e leximit të thellësi matësit në funksion të zbulimit të peshkut;
- Të shpjegojë mënyrat dhe mjetet e punës për përcaktimin e vendndodhjes së mjetit lundrues me objekte bregdetare dhe GPS;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të detyrave në raste rimorkimi;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të detyrave në raste avarish detare, alarmesh, ushtrimesh, etj.;
- Të shpjegojë zonat e komunikimit detar GMDSS¹⁰ dhe detyrat e radio operatorit detar;
- Të shpjegojë busullat magnetike dhe xhiroskopike;
- Të interpretojë hartat elektronike;
- Të shpjegojë baticë-zbaticat detare;
- Të argumentojë rëndësinë e raportimit në raste hedhje, qëndrimi dhe marrje spirance, manovrash, rimorkimi, avarish detare; alarmesh;
- Të analizojë situatat e rënies në raport me metodat e daljes nga cekëtina.

Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dhe riparimeve të thjeshta

- Të shpjegojë rëndësinë e mënyrave të kontrollit të funksionit të pajisjeve të kuvertës;
- Të interpretojë procedurat e mirëmbajtjes së pajisjeve të kuvertës;
- Të shpjegojë llojet e mjeteve të punës për mirëmbajtje në kuvertë, përdorimin dhe funksionimin e tyre;
- Të interpretojë mënyrat e mirëmbajtjes së mjeteve të punës në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë e kontrollit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së kushteve të punës dhe jetesës në mjete lundrimi peshkimi sipas ILO-s;
- Të interpretojë llojet e punimeve të thjeshta në riparim dokim, detyrat, mjetet, pajisjet, kushtet e punës, plani i punës etj.;
- Të shpjegojë konstruksionin e mjetit lundrues dhe elementët përbërës të tij;
- Të shpjegojë metodat e riparimeve të thjeshta, mirëmbajtjes, si dhe materialet e përdorura;
- Të argumentojë rëndësinë e gatishmërisë së pajisjeve dhe mjeteve të punës në lokalin e

⁸ International Maritime Organization

⁹ International Association of Marine Aids to Navigation and Lighthouse Authorities

¹⁰ Sistemi i Sigurisë ndaj Rrezikut Detar Glob

makinerisë;

- Të interpretojë mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjeteve të punës së lokalit të makinerisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të sistemit të ndriçimit dhe mënyrat e mirëmbajtjes së tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të sistemit të drejtimit dhe mënyrat e mirëmbajtjes së tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të sistemit të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe mënyrat e mirëmbajtjes së tij;
- Të argumentoj rëndësinë e mirëmbajtjeve të thjeshta në bord.

Kryerja e detyrave administrative dhe tregtare:

- Të shpjegojë llojet e dokumentacioneve;
- Të interpretojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së detarisë;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit e arkivimit të dokumentacioneve;
- Të realizojë mënyrat e llogaritjeve të materialeve dhe të grafikut të kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe përgatitjes së një oferte;
- Të argumentojë rëndësinë e raportimeve;
- Të analizojë metodat e monitorimit të çmimeve të tregut të materialeve bazuar në standardet e peshkimit;
- Të analizojë elementët e llogaritjes së kostos së materialeve dhe çmimit të një produkti;
- Të interpretojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të interpretojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet që do të ofrojnë;
- Të shpjegojë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të llogarisë elementet përfundimtare për produktet e ofruara;
- Të shpjegojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e produkteve dhe mënyrën e përgatitjes;
- Të interpretojë teknikat e marketingut.

Komunikimi në mënyrë etike dhe profesionale

- Të përshkruajë metodat e informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të interpretojë parimet e komunikimit etik dhe metodat e tij;
- Të përshkruajë parimet e punës në grup;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të rregullave bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të interpretojë Kodin e etikës;
- Të analizojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimin kritik;
- Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunëtorëve dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të TIK në komunikimin me të tjerët;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit:

- Të interpretojë parimet e standardit ndërkombëtar 18001;
- Të interpretojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për sigurinë dhe shëndetin në punë;

- Të interpretojë Kodin e sigurisë për peshkatarët dhe anijet e peshkimit ILO;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të argumentojë rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të interpretojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të procedurave të evakuimit për raste emergjence;
- Të argumentojë masat përkatëse në përdorimin e solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të shpjegojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
- Të interpretojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
- Të interpretojë mënyrat dhe mjetet e punës për pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të interpretojë rregulloret në përdorimin e solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të interpretojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
- Të interpretojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të interpretojë llojet e simbolikave në tabelat e sigurisë teknike;
- Të përshkruajë protokollet e duhura në raste pandemie.

Ngritja e nivelit profesional

- Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes;
- Të argumentojë metodat e zhvillimit profesional;
- Të argumentojë metodat e zhvillimit të karrierës;
- Të interpretojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në detari
- Të argumentojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët për njohuritë e aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të përshkruajë llojet e panairëve dhe ekspozitave;
- Të listojë literaturën bashkëkohore;
- Të përshkruajë llojet e trajnimeve e kurseve teknike.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Detari” niveli IV në KSHK, individi zotëron shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikimi dhe organizimi i punës para daljes së mjetit në det:

- Të hartojë një plan të thjeshtë ekonomik për aktivitetin duke marrë parasysh shpenzimet dhe të ardhurat;
- Të planifikojë rezervat hidrokarbure, ushqimore, mjetet dhe pajisjet e punës, kualifikimin e burimeve njerëzore dhe materialet referuar kohëzgjatjes së mundshme të lundrimit;
- Të identifikojë zonën e aktivitetit ekonomik duke marrë parasysh zonat e gjuetisë, strategjinë e peshkimit, periudhën e lejuar të gjuetisë, etj.;
- Të vlerësojë përshtatshmërinë e zonës së aktivitetit ekonomik duke marrë parasysh rreziqet

e mundshme në tabanin e fundit të detit, njoftimet meteorologjike, trafikun detar, aktivitetet ushtarake, të kërkim shpëtimit, kërkimore-shkencore, etj. në zonë;

- Të ndajë detyrat sipas pozicionit dhe kualifikimit të ekuipazhit;
- Të sigurojë rezervat hidrokarbure, ushqimore, mjetet dhe pajisjet e punës, burimet njerëzore, materialet e nevojshme sipas planifikimit të bërë;
- Të mbikëqyrë zbatimin e detyrave nga ekuipazhi sipas pozicioneve dhe përgjegjësive të tyre;
- Të kontrollojë vlefshmërinë e dokumentacionit bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit dhe legjislacionit në fuqi;
- Të raportojë periodikisht kryerjen e detyrave nga ekuipazhi;
- Të raportojë vazhdimisht gjendjen e rezervave hidrokarbure, ushqimore, mjetet e punës, gatishmërinë e burimeve njerëzore sipas kualifikimit, materialet e nevojshme për lundrimin e parashikuar;
- Të raportojë në kohë, vlefshmërinë e dokumentacionit;
- Të raportojë gjendjen funksionale të materialeve për reagim ndaj ndotjeve detare.

Sigurimi i gatishmërisë së mjetit për lundrim:

- Të sigurojë gatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas manualeve dhe instruksioneve të prodhuesit;
- Të kontrollojë mjaftueshmërinë e rezervave lundrimore (hidrokarbure, ujë, ushqime, etj.) duke marrë parasysh kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit;
- Të verifikojë sigurinë e objekteve të lëvizshme sipas teknikave të sigurimit;
- Të testojë funksionalitetin e pajisjeve radio-navigacionale sipas manualeve dhe procedurave përkatëse;
- Të kontrollojë vizualisht gjendjen e konstruksioneve dhe agregateve të skafit jashtë bordit, në kuvertë dhe lokalin e makinerisë për dëmtime të mundshme;
- Të kryejë testimin e gatishmërisë për punë të sistemit të drejtimit sipas procedurave përkatëse;
- Të kryejë testimin e gatishmërisë për punë të motorit kryesor dhe agregateve ndihmëse sipas procedurave përkatëse;
- Të verifikojë gjendjen dhe mjaftueshmërinë e kapaciteteve të depozitimit të mbetjeve në bord sipas parashikimeve ligjore;
- Të kontrollojë gjendjen e gatishmërisë për përdorim të mjeteve dhe pajisjeve për raste avarie/emergjence sipas inventarit dhe manualit të përdorimit;
- Të kontrollojë përdorimin, nga ekuipazhi, të veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse të punës sipas parashikimeve ligjore;
- Të verifikojë gjendjen e gatishmërisë për punë të impianteve të gatimit sipas manualeve të përdorimit;
- Të sigurojë përshtatshmërinë e kushteve higjieno-sanitare për ekuipazhin përfshirë mjetet e argëtimit (TV, lojëra, etj.) sipas parashikimeve ligjore;
- Të raportojë para nisjes për gjendjen e përgjithshme të mjetit për lundrim.

Mbikëqyra e veprimtarive në funksion të lundrimit:

- Të realizojë shtrimin grafik të lundrimit në hartën me letër dhe atë elektronike duke marrë parasysh njoftimet për detarët;
- Të hedhë në ditarin e lundrimit/makinerisë të dhënat lundrimore sipas udhëzimeve për plotësimin e ditarit dhe konstatimeve gjatë shërbimit;
- Të kryejë testimin e gatishmërisë së sistemit të spirancave sipas manualit dhe procedurës përkatëse;
- Të përditësojë të dhënat në AIS sipas rastit dhe manualit;
- Të përgatitë grafikun e shërbim-pushimit për ekuipazhin duke marrë parasysh kriteret për shmangien e mbi lodhjes;
- Të raportojë për zbatimin e grafikut të shërbim-pushimit për ekuipazhin dhe zbatimin e kriterëve për shmangien e mbi lodhjes;
- Të caktojë detyra për përgatitjen në kohë të mjeteve dhe pajisjeve të punës për gjueti sipas udhëzimeve të kapitenit dhe praktikave të punës;
- Të raportojë në kohë për zbatimin e detyrave për gatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të punës për gjueti;
- Të komunikojë me radion VHF DSC (very high frequency digital selective call) sipas kriterëve të komunikimit detar;
- Të mbikëqyrë zbatimin e teknikave të hedhjes së pajisjeve për gjueti nga ekuipazhi, sipas praktikave dhe instruksioneve të kapitenit;
- Të sigurohet për shfaqjen e dritave dhe simboleve përkatëse sipas REPAD për natyrën e aktivitetit detar;
- Të mbikëqyrë zbatimin e detyrave për ruajtjen e stabilitetit të mjetit lundrues në raste dëmtimesh strukturore në det;
- Të raportojë efektet e zbatimit të detyrave për ruajtjen e stabilitetit të mjetit lundrues në raste dëmtimesh strukturore në det;
- Të realizojë teknikat e kërkimit duke marrë parasysh interpretimin e leximeve të thellësi matësit apo shenja rrethore;
- Të raportojë për përshtatshmërinë e pozicionit për gjueti duke marrë parasysh interpretimin e leximeve të thellësi matësit apo shenja rrethore;
- Të caktojë detyrat për përpunimin paraprak të produkteve të zëna përfshirë masat për ruajtjen e freskisë së produktit të zënë sipas eksperiencës dhe grafikut të punës;
- Të verifikojë saktë vend-ndodhjen në hartë të mjetit lundrues në det duke përdorur sekstantin dhe pelengatorin ditor me objekte bregdetare dhe pajisje radionavigacionale;
- Të kryejë lëvizje manovruese sipas REPAD për shmangien e përplasjes në det;
- Të realizojë korrigjimin e busullës me metodën e përgjysmimit me vijë me mbulim me objekte bregdetare në tetë kurset kryesore me magnetët horizontal dhe vertikal;
- Të raportojë në kohë dhe periodikisht rezultatet nga gjuetia në ditar, Blue Box dhe me anë

të radios;

- Të caktojë detyra për përgatitje, hedhje, qëndrim dhe marrje spirance sipas nivelit të kualifikimit të ekuipazhit dhe instruksioneve të kapitenit;
- Të mbikëqyrë zbatimin e detyrave në raste manovrash, rimorkimi, avarish detare; alarmesh etj. sipas nivelit të kualifikimit të ekuipazhit dhe instruksioneve të kapitenit;
- Të raportojë në kohë për zbatimin si duhet të detyrave në raste hedhje, qëndrimi dhe marrje spirance, manovrash, rimorkimi, avarish detare; alarmesh etj.

Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dhe riparimeve të thjeshta

- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të kuvertës sipas manualeve dhe procedurave përkatëse;
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e kushteve të jetesës, higjiëno-sanitare dhe të argëtimit në bord sipas parashikimeve ligjore;
- Të caktojë detyrat e ekuipazhit për raste riparim-dokimi sipas planit të punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e saktë të detyrave në raste riparim dokimi;
- Të mbikëqyrë kryerjen e riparimeve të thjeshta në bord sipas instruksioneve të pajisjeve ose teknikës përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në lokalin e makinerisë sipas instruksioneve dhe teknikave përkatëse;
- Të raportojë periodikisht gjendjen funksionale dhe të mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës në lokalin e makinerisë;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemeve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike sipas manualit dhe instruksioneve përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemit të drejtimit sipas procedurave dhe manualeve përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemit hidraulik të agregateve sipas procedurave dhe manualeve përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemit të ftohjes për ruajtjen e freskisë së produkteve nga gjuetia, sipas procedurave dhe manualeve përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemit të sistemit të ngrohjes sipas procedurave dhe manualeve përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen funksionale dhe mirëmbajtjen e sistemit të motorit kryesor, motorëve ndihmuesve dhe agregateve të tij sipas instruksioneve dhe manualeve përkatëse.

Kryerja e detyrave administrative dhe tregtare:

- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës përkatëse në sektorin detar;
- Të plotësojë siç duhet ditarin e lundrimit/ makinerisë përfshirë informacionin mbi produktet/ shërbimet e ofruara dhe konsumet;
- Të ruajë dhe arkivojë dokumentacionin e punës së kryer, konsumimin e materialeve dhe

evidencat përkatëse sipas llojit të aktivitetit në sektorin detar;

- Të regjistrojë saktë të dhënat për faturat e lëshuara klientëve;
- Të marrë pjesë rregullisht në përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të kontrollojë rregullisht tregun në lidhje me çmimet dhe cilësinë e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të kryejë llogaritje të sakta të kostos së materialeve dhe produkteve të ofruara në bazë të një parashikimi;
- Të përgatisë siç duhet oferta për produktet që do të ofrojnë sipas me çmimeve të tregut;
- Të asistojë në blerjet e materialeve, mjeteve, pajisjeve sipas nevojave dhe standardit të peshkimit;
- Të llogarisë saktë çmimin përfundimtar për produktet e ofruara;
- Të plotësojë në kohë procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të porosisë të klienti për produktet e ofruara;
- Të zbatojë teknikat e duhura të marketingut për produktet që ofron sipas rregullave.

Komunikimi në mënyrë etike dhe profesionale

- Të marrë informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rehat e ditës;
- Të zbatojë drejt dhe saktë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë parimet e punës në grup në mënyrë korrekte;
- Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të japë dhe marrë udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës së punës duke përdorur terminologji të qartë në komunikim;
- Të zbatojë teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të shpejtë me të tjerët duke u përshtatur me to;
- Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura për zgjidhjen e konflikteve;
- Të përdorë terminologji profesionale rregullisht;
- Të veprojë në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit:

- Të zbatojë Standardin ndërkombëtar 18001, standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
- Të zbatojë saktë manualet përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Të respektojë sinjalistikën në mjediset e anijes sipas rregullores së brendshme;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike, sipas

Ilojit në mënyrë të saktë;

- Të identifikojë dhe të raportojë sipas rastit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të mbikëqyrë pastrimin dhe sistemimin rregullisht të vendit të punës para, gjatë dhe pas punës sipas llojit të punimeve;
- Të zbatojë rregulloret e ndarjes së mbeturinave sipas llojit para transportimit;
- Të ruajë dhe depozitojë mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të ruajë dhe magazinonë materialet në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racional energjinë dhe materialet, si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të mbikëqyrë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës sipas kushteve teknike;
- Të zbatojë në mënyrë rigorozë protokollet e duhura në raste pandemie.

Ngritja e nivelit profesional

- Të evidentojë boshllëqet e aftësive për detyrat e ngarkuara;
- Të përcaktojë qartë nevojat specifike për trajnim të vazhdueshëm;
- Të identifikojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në det;
- Të ndjekë trajnimet dhe të informojë në kohë bashkëpunëtorët për aplikimin e teknikave të reja në sektorin përkatës detar;
- Të studiojë vazhdimisht literaturë bashkëkohore për fushën e detarisë;
- Të marrë pjesë në panairë dhe ekspozita për thithjen e materialeve dhe instrumenteve bashkëkohore;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Detari” niveli IV në KSHK, individi zotëron shprehitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;

- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

¹ Konventa e Standardeve të Trajnimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Peshkatarët e vitit 1995.

² Konventa e Standardeve të Trajnimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e ndryshuar